



**V E N D I M**

***Nr. 114 Date 01.10. 2008***

**PER NDRYSHIMIN E KUSHTEVE TE LICENSES PER  
USHTRIMIN E  
AKTIVTETIT TE SHPERNDARJES SE ENERGJISE ELEKTRIKE  
NGA OSSH SH.A**

Në mbështetje të neneve 9, 15 dhe 19, pika 2, të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, te ndryshuar, pikes 7, te Modelit te Tregut te Energjise Elektrike, te miratuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 338 date 19.03.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 01.10.2008, mbasi shqyrtoi propozimin per ndryshimin e kushteve te licenses per ushtrimin e aktivitetit te shperndarjes se energjise elektrike nga OSSH sh.a,

**Dhe konstatoi se:**

- OSSH sh.a eshte licensuar nga ERE per aktivitetin e shperndarjes se energjise elektrike me Vendimin e Bordit te Komisionereve Nr.8 date 25.01.2008 “Per dhenien e licenses per aktivitetin e shperndarjes te energjise elektrike shoqerise OSSH sh.a”
- Modeli i tregut te energjise elektrike i miratuar nga Keshilli i Ministrave parashikon ne piken 7, rolin e ERE e cila duhet te procedoje me rishikimin e akteve nenligjore qe lidhen me funksionimin e tregut te energjise elektrike,



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



- Me vendimin nr.108, date 09.09.2008 Bordi i Komisionereve miratoi Rregulloren per procedurat e licensimit ne te cilen afati i vlefshmerise se licenses per aktivitetin e shperndarjes eshte ne harmoni me afatin e vlefshmerise se licenses te aktivitetit te shperndarjes te percaktuar ne modelin e licenses per kete aktivitetet ,
- Me vendimin nr. 69, date 24.06.2008 Bordi i Komisionereve ka miratuar licensen per aktivitetin e shperndarjes se energjise elektrike
- Ligji per sektorin e energjise elektrike i atribuon ERE-s te drejten qe me inicativen e vet te ndryshoje kushtet e nje license kur ka ndryshim ne kuadrin ligjor,

Per gjithë sa me sipër dhe me qëllim që, aktet nenligjore te miratuara nga ERE ne funksion te implementimit te Modelit te Tregut te Energjise Elektrike, te reflektohen edhe ne ushtrimin e aktivitetit nga subjektet e licensuara, Bordi i Komisionereve te ERE-s

**Vendosi:**

1. Duke filluar nga data e hyrjes ne fuqi te ketij vendimi, OSSH sh.a eshte subjekt i kushteve te licenses se miratuar nga ERE me Vendimin nr.69 date 24.06.2008 "Per miratimin e licenses per aktivitetin e shperndarjes se energjise elektrike".



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



---

2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftoje shoqerine OSSH sh.a per vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s**

**Bujar Nepravishta**